



FONDI SHQIPTAR I ZHVILLIMIT
FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

[Data : 17.02.2016]

Për: Operatorin ekonomik “Taulant” shpk me NIPT K61617040L

Procedura e prokurimit: **“Kërkesë për Propozime”** me objekt : **“Mbikqyrje punimesh per “Rehabilitimi I rrugës Transballkanike Fazat 1 dhe 2” dhe “Ndertimi i rruges Dhimiter Konomi Vlore”**.

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **“Mbikqyrje punimesh per “Rehabilitimi I rrugës Transballkanike Fazat 1 dhe 2” dhe “Ndertimi i rruges Dhimiter Konomi Vlore”**.

Kohëzgjatja:

Kohëzgjatja “Mbikqyrje punimesh per objektin “Rehabilitimi I rrugës Transballkanike Fazat 1 dhe 2”” eshte 190 dite kalendarike nga data e fillimit te punimeve.

Kohëzgjatja “Mbikqyrje punimesh per “Ndertimi i rruges Dhimiter Konomi Vlore”” eshte 14 muaj nga data e fillimit te punimeve.

Fondi limit: **2.765.030 (dy milion e shtateqind e gjashtedhete e pese mije e tridhete) lekë** pa tvsh.

Burimi i financimit: Buxheti i Shtetit.

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: **Datë 01.02.2016.**

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Nuk ka patur.

Njoftojmë se per kete lot kanë qënë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara pa tvsh:

NR	OPERATORI EKONOMIK	OFERTA PA TVSH RRUGA TRANSBALLKANIKE	OFERTA PA TVSH DHIMITER KONOMI	OFERTA PA TVSH
1	DERBI-E	589,000	1,290,000	1,879,000
2	A & E ENGINEERING sh.p.k	600,000	1,300,000	1,900,000
3	"PALMA CONSTRUACION"	561,200	1,438,000	1,999,200
4	GEOSAT GROUP	599,549	1,474,223	2,073,772

5	TOWER SHPK	685,780	1,792,423	2,478,203
6	"TAULANT" SHPK	685,781	1,792,423	2,478,204
7	TRANSPORT HIGHWAY CONSULTING	685,780	1,792,493	2,478,273
8	HE & SK 11 11	NUK KA OFERTE		

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtem me arsyet përkatëse:

Bashkimi i perkohshem i shoqerive “Derbi E” shpk (85%) dhe “Infrakonsult” shpk (15%) per arsye se:

Shoqeria “Derbi E” shpk nuk ploteson piken 2.1d te Kerkesave te Vecanta per Kualifikim pasi mungon vertetimi per shlyerjen e detyrimeve ndaj OSHEE per muajin Dhjetor 2015 (detyrim ky i maturuar ne daten 01 Shkurt 2016, dita e tenderit).

Shoqeria “Infrakonsult” shpk nuk ploteson piken 2.1d te Kerkesave te Vecanta per Kualifikim pasi mungon vertetimi per shlyerjen e detyrimeve ndaj OSHEE per muajin Dhjetor 2015 (detyrim ky i maturuar ne daten 01 Shkurt 2016, dita e tenderit).

Oferta e paraqitur eshte me e ulet se vlera minimale e lejuar e percaktuar ne nenin 7 te Vendimit te Keshillit te Ministrave Nr. 704, datë 29.10.2014 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”.

Shoqeria “A&E Engineering” shpk per arsye se:

Nuk ploteson piken 2.1d te Kerkesave te Vecanta per Kualifikim pasi mungon vertetimi per shlyerjen e detyrimeve ndaj OSHEE per muajin Dhjetor 2015 (detyrim ky i maturuar ne daten 01 Shkurt 2016, dita e tenderit).

Oferta e paraqitur eshte me e ulet se vlera minimale e lejuar e percaktuar ne nenin 7 te Vendimit te Keshillit te Ministrave Nr. 704, datë 29.10.2014 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”.

Shoqeria “Palma Costrucion” shpk per arsye se:

Nuk ploteson piken 2.3.2 te Kerkesave te Vecanta per Kualifikim pasi Ing. hidroteknik Kujtim Domnori, ka kontrate me kompanine nga korriku 2015 por ne bordero figuron vetem per muajin korrik 2015. Gjithashtu Ing. gjeologe Zamira Kallugjeri ka kontrate me kompanine nga korriku 2015 por ne bordero figuron vetem per muajin korrik 2015.

Nuk ploteson piken 2.3.4 te Kerkesave te Vecanta per Kualifikim “Operatori Ekonomik duhet te kete jo me pak se 8 (tete) punonjës te siguar për çdo muaj për periudhën mars 2015 – dhjetor 2015. Per te vertetuar kete kusht, Operatori Ekonomik duhet te paraqese vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj per kete periudhe, i cili duhet te perputhet me liste pagesat e punonjesve për kete periudhe” per muajin mars 2015 ka 6 punonjes dhe jo 8. Theksojme se ne kerkese eshte kerkuar qe operatori ekonomik te kete jo me pak se 8 (tete) punonjës te siguar për çdo muaj dhe nuk eshte kerkuar qe numri mesatar te jete jo me pak se 8.

Oferta e paraqitur eshte me e ulet se vlera minimale e lejuar e percaktuar ne nenin 7 te Vendimit te Keshillit te Ministrave Nr. 704, datë 29.10.2014 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”.

Bashkimi i perkohshem i shoqerive “Geosat Group” shpk (60%) dhe “ASH Engineering” shpk (40%) per arsye se:

Shoqeria “Geosat Group” shpk nuk ploteson piken 2.2.4 te Kerkesave te Vecanta per Kualifikim “Operatori Ekonomik duhet te paraqese një dokument që vërteton se ka plotësuar te gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore ku operatori ushtron aktivitet” pasi nuk ka paraqitur vertetimin e kerkuar.

Shoqeria “Geosat Group” shpk nuk ploteson piken 2.3.2 te Kerkesave te Vecanta per Kualifikim pasi per ing hidroteknik Gentian Lula mungon licensa, ndersa per ing hidroteknik Antoneta Hodaj mungon licensa dhe cv.

Shoqeria “ASH Engineering” shpk nuk ploteson piken 2.3.2 te Kerkesave te Vecanta per Kualifikim pasi per ing gjeolog Aleksander Rukaj nuk ka paraqitur diplomen.

Shoqeria “ASH Engineering” shpk nuk ploteson piken 2.3.5 te Kerkesave te Vecanta per Kualifikim lidhur me realizimin e shërbimeve te ngjashme pasi ka paraqitur disa kontrata mbikëqyrje dhe kolaudimi, por vetem kontrata “Supervizion i rikonstruksionit te rrugeve te brendeshme ne komunen Ishem” eshte e plotesuar me dokumentacionin e kerkuar (vertetim dhe fature). Ky dokumentacion nuk eshte i mjaftueshem pasi vlera e punes pa tvsh eshte 384.000 leke, nderkohe qe

sipas perqindjes se sherbimit qe ka marre persiper kjo shoqeri (40%) duhet te kishte paraqitur dokumentacion per realizimin e nje pune me vlere jo me pak se 442.404 leke pa tvsh.

Oferta e paraqitur eshte me e ulet se vlere minimale e lejuar e percaktuar ne nenin 7 te Vendimit te Keshillit te Ministrave Nr. 704, datë 29.10.2014 "Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim".

Bashkimi i perkohshem i shoqerive "Tower" shpk (51%) dhe "Sphaera" shpk (49%) per arsye se:

Ne marreveshjen e bashkepunimit nuk jane percaktuar punet konkrete qe do te kryeje secila shoqeri, ne kundershtim me nenin 74, pika 1 te Vendimit te Keshillit te Ministrave nr. 914 date 29.12.2014 "Per miratimin e rregullave te Prokurimit Publik" ku citohet: "Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe në rast përzgjedhjeje edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi". Ne kete menyre eshte e pamundur per KVO te gjykoje per plotesimin e kriterëve per kualifikim nga secila shoqeri.

Shoqeria "Tower" shpk nuk ploteson piken 2.3.2 te Kerkesave te Vecanta per Kualifikim mungon arkitekti, ing mjedisit dhe topografi. Duke qene se ne marreveshje nuk jane ndare punet ishte e domosdoshme qe ky kriter per kualifikim te plotesohej nga secila prej kompanive.

Bashkimi i perkohshem i shoqerive "Transport Highway Consulting" shpk (42%), "Erald-G" shpk(33%), "C.E.C Group" shpk (17%), dhe "Ecuale" shpk (8%) per arsye se:

Shoqeria "Ecuale" shpk nuk ploteson piken 2.1d te Kerkesave te Vecanta per Kualifikim pasi mungon vertetimi per shlyerjen e detyrimeve ndaj OSHEE per muajin Dhjetor 2015 (detyrim ky i maturuar ne daten 01 Shkurt 2016, dita e tenderit).

Shoqeria "He & Sk 11" shpk per arsye se: nuk ka paraqitur oferte .

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë operatorin ekonomik "**Taulant" shpk, me NIPT K61617040L**, se oferta e paraqitur, me vlerë 2,478,204 (**dy milion e katerqind e shtatedhjete e tete mije e dyqind e kater**) lekë pa TVSH është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë **Autoritetit Kontraktor:**

- **Fondi Shqiptar i Zhvillimit**
- **Rr. "Sami Frashëri", Nr. 10, Tirana, Albania**
- **Phone: 00355 4 2 235 597/8 (int.151)**
- **Fax: 00355 4 2 234 885**

sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda pese ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë **09.02.2016**.

Ankesa: Nuk ka patur.